

Të nderuar!

Lidhur me kërkesen tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se në Kolegjin e Posaçëm të Apelit rezultoi i administruar 1 (një) opinion i një prej vëzhguesve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, me nr 633/35 prot., datë 26.04.2019.

Sqarojmë se bazuar në nenin 17, pika 1/c të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, vënia në dispozicion e kopjeve të opinioneve të vëzhguesve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit lidhur me çështjet e shqyrtuara në KPA, do të dëmtonte interesin e së drejtës së autorit, rrjedhimisht kufizohet.

Bazuar në vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nr. 08, datë 25.04.2019, një mendim me shkrim ndryshe ose paralel i vëzhguesit ndërkombëtar, nuk mund t’i bashkohet vendimit përfundimtar të Kolegjit, nuk mund të bëhet pjesë e fashikullit gjyqësor të çështjes, si dhe nuk mund të publikohet së bashku me vendimin përfundimtar në faqen zyrtare të Kolegjit.

Faleminderit!